



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 04.08.2023, nxjerrë këtë:

Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot. No.
06	
Nr.i Faq.	Data
Br. Str.	Datum
Nr. Page.	Dan
02 07.08.2023	
PRISHTINA	

## V E N D I M

Mbylltet rasti APK-DPKI-06-1264/23, për zyrtaren e lartë znj. Adelinë Sahiti, Drejtore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Adelinë Sahiti, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se znj. Adelinë Sahiti, krahas ushtrimit të funksionit publik Drejtore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës, është edhe përfaqësuese e autorizuar në biznesin privat “Adelinë Sahiti” B.I.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-02/1323/23, e ka njoftuar zyrtaren e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, znj. Adelinë Sahiti është njoftuar lidhur me faktet për rastin e saj, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Zyrtarja e lartë znj. Adelinë Sahiti, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka dekluaruar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë - konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën nga zyrtarja në fjalë, të cilën më pas e ka konsfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/1323-1/2023), se zyrtarja e lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit tek një person tjeter (personi i besuar).

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtarja e lartë znj. Adelinë Sahiti, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpagragafi 1.1 lidhur me nenin 15 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtarja e lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

  
Ylli Buteshkaj  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korruptionit  


- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)